



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-129

Prishtinë, më 14 tetor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 TETOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Petar Miletiq dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 30 shtator dhe 2 tetor 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 30 shtator dhe 2 tetor 2013

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 30 shtator dhe 2 tetor 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që seanca plenare të mbahet të enjten, më 17 tetor 2013, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
4. *Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet normative,*
9. *Emërimi i anëtarëve të Organit Përzgjedhës të Pavarur për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,*

10. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Për pikën e katërt të rendit të ditës së seancës plenare- Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së diskutuan: Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Sasha Milosavljeviq, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, kërkoi nga Kryesia e Kuvendit që ta procedojë pikën e papërfunduar nga seanca e mëparshme - shqyrtimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së, ngase për këtë raport është diskutuar në seancë plenare, por Kuvendi nuk ka vendosur lidhur me të.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave:

1. Propozimi për shpalljen e konkursit për katër anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin për shpalljen e konkursit për katër (4) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ta shpallë konkursin për katër (4) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sipas tekstit të bashkangjitur.

2. Njoftimi i Komisionit për Integritet Evropian për vizitën zyrtare të realizuar në Zagreb, prej datës 18-20 shtator 2013

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Integritet Evropian, të realizuar në Zagreb, prej datës 18-20 shtator 2013.

3. Njoftimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së për vizitën zyrtare të realizuar në Slloveni, prej datës 23-26 shtator 2013

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, të realizuar në Slloveni, prej datës 23-26 shtator 2013.

Pikat shitesë:

1. Njoftimi i Presidentes së Republikës së Kosovës për fillimin e nismës ligjore për hartimin e Projektligjit të ri për falje

Kryesia u njoftua lidhur me iniciativën e Presidentes së Republikës së Kosovës për fillimin e nismës ligjore për hartimin e Projektligjit të ri për falje.

2. Kërkesa e Shoqatës së Veteranëve të LANÇ së Kosovës për mbulimin e shpenzimeve me rastin e shënimit të 70-vjetorit të Konferencës së Bujanit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës për mbështetje financiare, në shumën prej 9.500 euro për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për shënimin e 70-vjetorit të Konferencës së Bujanit, që do të mbahet në hapësirat e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 13 dhjetor 2013.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale